**VENDIM**
**Nr.503, datë 13.7.2011**

**PËR MIRATIMIN E MODELIT TË UNIFORMAVE, GRADAVE E SHENJAVE QË MBAHEN NË UNIFORMË, SI DHE TË STEMAVE TË STRUKTURAVE E TË FLAMUJVE DEKORATIVË, QË MBAJNË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 16 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e modelit të uniformave, gradave e shenjave që mbahen në uniformë, si dhe të stemave të strukturave e të flamujve dekorativë, që mbajnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas albumeve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Kalimi në modelin e uniformave, sipas këtij vendimi, të bëhet brenda vitit 2014, ndërsa modelet e stemave të strukturave dhe flamujve dekorativë të aplikohen brenda vitit 2011.
3. Ministri i Mbrojtjes miraton rregulloren për mënyrën e përdorimit të uniformës nga ushtarakët e Forcave të Armatosura, si dhe të stemave të strukturave e të flamujve dekorativë.
4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen brenda buxhetit vjetor, të miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
5. Vendimi nr.124, datë 4.3.2004 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e uniformave, të gradave dhe shenjave, që mbahen në uniformën ushtarake të Forcave të Armatosura", shfuqizohet.
6. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**